



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës - Ministarstvo Inostranih Poslova i Diaspore
Ministry of Foreign Affairs and Diaspora

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës shpall:

Konkurs

Lëvizje brenda kategorisë

Të drejtë për aplikim në këtë procedure kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

Titulli i pozitës së punës	Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative
Klasa e pozitës	Profesional 1
Koeficienti/Paga	8
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	28/12/2021
Afati për aplikim	12/01/2022 - 19/01/2022
Institucioni	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
Departamenti	Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme
Divizioni	Divizioni i TI dhe Shërbimeve Logjistike
Vendi i punës	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
Nr. i Referencës	RN00008001
Kodi	RPC0001805



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Bënë sigurimin dhe mirëmbajtjen e projekteve të Teknologjisë Informatike në interes të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Është përgjegjës për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të Teknologjisë Informatike, zbatimin e legjislacionit dhe monitorimin e dispozitave të shërbimit të TI-së në MPJD;
- Mirëmban sistemin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporën siç janë: e-maili zyrtar, operimi me rrjeta, instalimi dhe riinstalimi i të gjitha pajisjeve të TI-së;
- Kryen shërbimet e mirëmbajtjes dhe konfigurimit të kompjuterëve. Instalon kompjuterët me softuerët e aprovuar nga divizioni i TI-se, instalon pajisjet kompjuterike periferike si dhe shtypësin dhe skanerët;
- Mbikëqyrë përdorimin dhe kryen azhurnimin e programeve specifike që janë në përdorim nga MPJD, siguron që të punësuarit në institucionin i përmban politikave dhe standardeve të TI-se në fuqi; • Mirëmban rrjetin LAN në objektin e MPJD-se, kyç dhe largon nga rrjeti LAN kompjuterët;
- Mban seanca trajnime me personelin e ri sipas kërkesës (lidhur me kompjuterët, internet, videokonferenca, telefonin VoIP, mobil, etj); • Kryen detyra tjera lidhur me vendin e punës, sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

- Të jetë nëpunës civil i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

A- Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare: IT/Inxhinieri Informatike, , Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Telekomunikacioni, shkencë kompjuterike ose inxhinieri softuerike me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (Në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasoje e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor) me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (Në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasoje e diplomës).

B- Kualifikime të posaçme formale: Certifikatë të trajnimeve në lëmin TI-së; MCSA, MCSE ,CCNA

C- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.



4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 26/01/2022, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

- 04.02.2022 (dt.planifikuar), Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, rr. "Luan Haradinaj", kati I, salla nr.103, Prishtinë

8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

- Njohuritë e thella dhe të specializuara në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse; • Njohuritë e ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Aftësitë për të krijuar marrëdhënie pune të shkëlqyeshme ndër-personale; • Njohuritë e mira për të përcaktuar prioritetin e detyrave të rëndësishme;
- Shkathtësitë në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësitë hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale.

9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Intervist

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



11. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

